

VENDIM
Nr. 1072, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E
ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE, 2016-2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministratë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR
I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË, 2016-2020
NËNTOR 2015

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministritë e linjës në konsultim të ngushtë me përfaqësues të autoriteteve vendore, organizatave ndërkombëtare, me kontributin e përfaqësuesëve të shoqërisë civile përfshirë edhe organizatat rome dhe egjiptiane, ekspertë të fushës si dhe me pjesëmarrjen aktive të ekspertëve romë dhe egjiptianë .

Ekspertizë dhe asistencë teknike për përgatitjen e dokumentit është ofruar nga Projekti “Mbështetje për Përfshirjen Sociale të Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane – SSIREC” financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Agjensia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim – PNUD në partneritet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.